

Raste të veçanta të furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja

Shërbimet postare dhe pullat

Bazuar në Ligjin Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përjashtohen nga TVSH-ja:

- furnizimi i shërbimit postar i kryer nga shërbimi publik postar në Shqipëri, në përputhje me shërbimin universal postar;
- furnizimi me vlerën e parashtypur i pullave postare për përdorim për shërbime postare në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pullave të tjera të ngjashme;]

Kujdes!

Ky përjashtim përfshin vetëm “furnizimet”, domethënë shitjet e pullave. Nuk përfitojnë nga përjashtimi, shtypja e pullave ose transporti i tyre, etj. Gjithashtu, i nënshtrohen TVSH-së, shitjet e pullave të koleksionit nga koleksionistët për qëllime tregtare.

Furnizimi i tokës, ndërtesës dhe dhënia me qira e pasurive të paluajtshme

Janë të përjashtuara nga TVSH-ja, furnizimi i tokës dhe furnizimi i ndërtesave apo i pjesëve të një ndërtese si dhe furnizimi i tokës, në të cilën qëndron ndërtesa.

- ❖ Nuk është i përjashtuar nga TVSH-ja, furnizimi i procesit të ndërtimit !

Gjithashtu, dhënia me qira e pasurive të paluajtshme është furnizim i përjashtuar, përveç rasteve si më poshtë:

- dhënies me qira të ndërtesave për një periudhë deri në dy muaj;
- strehimit në hotele ose vende pushimi, të kryera në sektorin e hotelerisë ose në sektorë që kanë funksione të njëjta, përfshirë qiradhënien e kampeve të pushimit apo të terreneve të pajisura për kampingje;
- dhënien me qira të zonave të destinuara për parkimin dhe magazinimin e automjeteve dhe mjeteve të tjera lëvizëse;
- dhënien me qira të pajisjeve dhe makinerive të fiksuara në mënyrë të qëndrueshme;
- dhënien me qira të kasafortave.

Përrjashtime të tjera

Furnizimi i basteve, lotarive dhe lojërave të tjera të fatit, në kuptim të ligjit për lojërat e fatit përjashtohen nga TVSH-ja.

Kujdes!

Nuk janë objekt i përjashtimit nga TVSH-ja çdo furnizim malli ose shërbimi (që nuk parashikohen në ligjin për Lojrat e Fatit) që kryhet përgjatë organizimit të lojërave, ose që kryhet nga shoqëritë e licencuara për organizimin e këtyre lojërave. Gjithashtu, nuk janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, komisionet për shërbimet e ndërmjetësimit ose komisionet e agjentëve për shitjen e biletave të lojërave apo lotarive të ndryshme, përse ligji nuk i përcakton këto përjashtime, si dhe përse këto shërbime nuk janë objekt i tatimit të ligjit të lojërave të fatit.